

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni Juridik dhe Rendit Publik
të Këshillit Bashkiak Tropojë**

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 01 datë 03.05. 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për Planin e Integritetit

Komisioni Juridik dhe Rendit Publik të Këshillit Bashkiak Tropojë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Integritetit të Bashkisë Tropojë. Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe bazës ligjore, komisioni thekson se ky plan është një instrument strategjik për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

BAZA LIGJORE

Hartimi dhe miratimi i Planit të Integritetit mbështetet në legjislacionin në fuqi, përfshirë: Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton funksionet dhe detyrat e njësive të qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve dhe forcimin e transparencës e llogaridhënies.

Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili kërkon respektimin e parimeve të etikës dhe integritetit në administratën publike.

Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023–2030 dhe Udhëzimet e Agjencisë Kundër Korrupsionit në nivel vendor për hartimin e Planeve të Integritetit.

QËLLIMI DHE RËNDËSIA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një instrument thelbësor për të parandaluar dhe menaxhuar Rreziqet që lidhen me korrupsionin, keqadministrimin apo abuzimet në administratën vendore.

Ky plan:

Identifikon praktikën me risk të lartë për integritetin institucional;

Parashikon masa parandaluese dhe korrigjuese për çdo risk të identifikuar;

Forcon kulturën e etikës dhe përgjegjshmërisë në administratë;

Rrit besimin e publikut në institucionet vendore dhe përmirëson cilësinë e shërbimeve.

Përfundime dhe Rekomandime

Komisioni Juridik dhe Rendit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, bazuar edhe ne degjese publike te realizuar per kete qellim, arrin në përfundimin se Plani i Integritetit është një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Bashkisë Tropojë. Ky plan kontribuon në forcimin e rolit të gruas, rritjen e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët.

Në këtë kuadër, **Komisioni Juridik dhe Rendit Publik** i propozon Këshillit Bashkiak Tropojë miratimin në tërësi të Planit Integritetit.

Per Komisionin: